



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.

Konsultim publik : Rajoni nr.3.

Data : 20.10.2023

Ora : 15:00

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : Numri i pjesëmarrësve 29, nga të cilat 7 gra, dhe 22 burra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr **Z.Ervin Gjini**, banor i rajonit nr. 3, i cili shprehet se kjo zonë ka lagjet më të vjetra të qytetit me 70 % të qëndrës historike. Po ashtu ka tre shkollame numër të madh nxënësish si: Shkolla e Muzikës, Shkolla Jordan Misja, Shkolla Branko Kadija, ku hyrja e kësaj

të fundit është në një gjëndje shumë të keqe, në periudhën se rreshjeve pasi oborri dhe rruga janë përherë të pakalueshme. Midis këtyre dy shkollave, Jordan Misja dhe Branko Kadija ka gjithashtu një hapësirë të shfrytëzuar nga privati dhe duhet të planifikohet një ndërhyrje që lehtëson aksesin në shkollë. Pra është i nevojshëm sistemimi i ambjentit të jashtëm dhe i rrjetit të kanalizimeve pranë shkollës.

Zv/Sonila Milloja, zv.drejtoreshë shkollë Branko Kadija shprehet se:

1. Kjo shkollë nuk ka hyrje konkretisht aty sepse kalojnë shumë familjare që kanë hyrjedaljet e shtëpive të tyre në oborrin e shkollës.
2. Gjatë rreshjeve rruga është e pakalueshme.
3. Në oborrin e shkollës ka edhe një pikë shitje të produkteve të ndryshme e cila duhet verifikuar.
4. Rrjeti elektrik i shkollës është i amortizuar.
5. Ngrohja vijon të jetë me gaz në këtë shkollë.

Po punohet në ndërhyrje infrastrukture në këtë shkollë, por nuk ka investim të kaldajës, prandaj dr. Arsimit duhet të verifikojë situatën.

Z.Ervin Gjini përsëri shton se si zonë muzeale, duke parë edhe interesin e madh të banorëve dhe turistëve, kjo zonë duhet të ketë vëmendje të shtuar. Por:

1. Tabelat dhe rregulli i qarkullimit në këtë zonë nuk zbatohen duke krijuar kaos për banorët, duhet të përcaktohet një rregullore dhe të vendoset shërbim policimit bashkiak në këtë zonë.
2. Investimet që po realizohen në këtë zonë shpesh janë të pakontrolluara duke anashkalu ligjin e monumenteve të Kulturës, për më tepër ato nuk pastrojnë mbetjet e lëna duke dëmtuar edhe rrugën pedonale (G'juhadol).
3. Ndryshimi i zonës duhet të riparohet ose të ndërrohet sepse mungojnë shtyllat apo ndriçuesit në zona të ndryshme të pedonales.
4. Ka objekte për të cilat megjithëse ka patur leje zhvillimi nuk janë përfunduar investimet dhe shpesh këto objekte janë tepër të amortizuara duke krijuar edhe rrezikshmëri dhe aksidente për kalimtarët/ banorët.
5. Për më tepër kemi një pjesë të madhe informale në rajonin nr. 3. Banorët e zonës informale duhet të përfshihen në sistemin e taksapagimit të bashkisë.

Z.Martin, banor pranë ish-Nesherakut shprehet se:

1. Rruga Karl Gega ka rreth 156 metra linear të pashtuara.
2. Rruga Pjetër Budi 280 metra linear e pashtuar

Ai shton se ka 32 vite që nuk është bërë asnjë investim në këtë zonë. Ka shumë nevoja si p.sh kanalizimet e ujrave të zeza dhe të bardha në këto rrugë dhe asfaltimi i tyre.

Z.Zef Koceku, banor lagjja nr. 3 thotë se lagjja Skenderbeg ka shumë nevojë për investime. Nuk ka as lulishte as hapësira publike, as trotuare, as ndriçimi publik. Po ashtu ai shton:

1. Transporti urban nuk respektohet frekuenca e këtij shërbimi.

2. Gjithashtu nuk vlejnjë dok. e invaliditetit apo pensionistëve sa i përket pagesës së biletës.
3. Zona e pedonale ka përherë makina të parkuara dhe është i vështirë kalimi në këtë zonë.
4. Ka akoma punë për pastrimin e trotuareve dhe makinave të vjetra të parkuara.
5. Pastrimi në zone nuk është i kënaqshëm.
6. Korsitë e biçikletave duhet të vazhdojnë edhe drejt zonës së Spitalit dhe ish Fermentimit sepse ka shumë biznese dhe fluks.
7. Kontrolli i makinave dhe parkingjeve duhet të jetë më i rreptë dhe me gjoba.

Zv/Kryetar Z.Rudin Beka shprehet në lidhje me transportin se jemi në monitorim të vazhdueshëm të kësaj situate. Po komunikojmë me operatorit ekonomik që ofron këtë shërbim për të gjetur formën e mbeshtetjes. Po ashtu pastrimi mendoj që po bëhet një punë duke shtuar si numrin e kazanëve ashtu edhe frekuencën .

Znj.Ina Xhakoni, përgjegjëse në dr.Shërbimeve publike në Bashkinë Shkodër shprehet se përse i përket fshirjes së qytetit, ky është një shërbim që zhvillohet gjatë natës .Është e vërtetë që ka patur probleme me operatorin për kryerjes e këtij shërbimi por është penalizuar nga ana jonë. Po ashtu për mirëmbajtjen e pikave të grumbullimit jemi gjithë kohës në terren duke mbikqyrur këto pika. Gjithashtu kërkojmë edhe bashkëpunimin e banorëve për këtë sektor sepse në koshat e vegjël nuk mund të hidhen mbetjet e familjarëve ose bizneset dhe si zgjidhje lihen në rrugë.

Zv/Kryetari shton se jemi në proces të ristrukturimit të policisë bashkiake duke shtuar numrin dhe sektorët e saj. Po ashtu jemi pranë miratimit të rregullores për gjobat e policisë bashkiake sa i përket zënies së hapësires publike apo trafikut.

Znj.Vera Zhivani, banore rajoni nr. 3 merr fjalën dhe shprehet se është këto janë kërkesa të paplotësuara prej 30 vitesh dhe nuk mund të pretendohet realizim i menjëhershëm i tyre. Ajo shton se :

1. Ka kontaktuar me shumë familje gjatë kësaj periudhe në kuadër të censit dhe është njohur me shumë familje që kanë PAK apo vështirësi familjare prandaj duhet të përfshihen në skemat e ndihmës nga ana e Bashkisë. Nuk ka asnjë shoqatë që mbështet këtë kategori.
2. Nga zona e fermentimit deri tek policia këto invalidë nuk mund të aksesojnë rrugët sepse trafiku është shumë i ngarkuar dhe ka perheë makina të parkuara keq dhe nuk ka një trotuar të rregullt.
3. Pensionistët invalidë për të cilët nuk ka asnjë ndihmë duhet të parashikohet një ndihmë nga ana e Bashkisë si mbështetje për to, sepse nuk kanë as të ardhura dhe as mbështetje nga askush.

Zv/Kryetari përgjigjet se në lidhje me transportin jemi në proces të realizimit të studimit të mobilitetit për të gjithë qytetin, prandaj ndërhyrjet do jenë të harmonizuara për të gjithë Shkodrën. Padyshim që këtë vëmendje të shtuar ndaj personave dhe problematikës së moshës së tretë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak **Z.Luli** shton që do të përpiqemi të bëjmë fuqizim të qendrave komunitare dhe do të kemi rezultate në këtë sektor.

Z.Vilson Peshkaj, thotë po ashtu se nga kryqëzimi i spitaleve tek ura Bardhaj ka dy rrugica të pashtuara ku ujësjellësi në këtë zonë është shumë problematik sepse ka familje që nuk kanë rrjet fare për ujin. Po ashtu nga Ura e Bardhajve deri në kryqëzimin e Prek Calit nuk ka asnjë shkollë apo kopësht pasi është zonë me numër të madh banorësh.

Znj.Suela Tirana drejtoresha e shkollës Mati Logoreci shpreh shqetësimet e shkollës që ajo drejton:

1. Oborri dhe rrethimi është problem për këtë shkollë sepse nuk ka sistem të kanalizimeve duke u përmytur.
2. Sistemi elektrik i amortizuar.
3. Ngrohja akoma me gaz
4. Familjarët që aksesojnë oborrin e shkollës sepse kanë aty hyrje- daljet e shtëpive.

Z.Paolo Kaceri, banor pranë varrezave katolike shprehet shkolla Branko Kadija ka problem me aksesin e saj pasi ka gjithmonë parking makinash pranë saj, po ashtu oborri është i pakalueshëm nga uji. Ai shton se infrastruktura në këtë zonë lë shumë për të dëshiruar dhe është e lënë pas dore. Ka lagje që kanë lulishte, ndriçim, trotuare, kënde lojrash etj, por në Skenderbeg nuk është realizuar asnjë investim. Ai shton se duhet riparë sinjalistika dhe vazhdimi i korsive të bicikletave edhe në zonën në fjalë.

Zv/Kryetari shprehet se është në proces zbatimi i kësaj ndërhyrjeje.

Po ashtu **Z.Paolo Kaceri** shton se :

1. Rruga nga spitali deri tek Dugajt e reja është shumë e amortizuar sa i përket trotuareve, shtyllave, rrugës dhe asfaltimit.
2. Makinat janë përherë të parkuara keq ose në trotuar duke penguar kalimin.
3. Kemi 2-3 fasoneri në zonën industriale në të cilat është i pamundur kalimi i punonjësve. Janë ndërhyrje të thjeshta dhe duhet të behen sepse japin një impakt të lartë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak përgjigjet duke thënë se një pjesë e kërkesave që dhatë do të adresohen pranë drejtorive përkatëse për tu dhënë përgjigje sepse nuk kanë nevojë për planifikim buxhetor. Kurse për planifikimin e investimeve ne duam të marrim prioritetet nga ana e juaj për të bërë të mundur realizimin e investimeve sipas prioriteteve dhe nevojës duke shpërndarë në mënyrë të barabartë investimet në territor.

Z.Jozef Coba, banor G'juhadol merr fjalën duke thënë se kemi bërë një takim me Kryetarin e Bashkisë si banorë të kësaj zone duke shprehur problematikat tona. Ai shton se:

1. Zona ka muzikë shumë të lartë.
2. Ka bllokim të rrugës dhe trotuareve pa kriter nga makinat por më shumë nga bizneset.
3. Të vendoset edhe sinjalistikë horizontale.

4. Tashmë rrugicat e Gjuhadolit janë të gjitha vetëm për parkimin e automjeteve të frekuentuesve të lokaleve kurse ne si resident nuk mund të hymë në shtëpitë tona me makina. Duhet gjetur një zgjidhje për këtë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak sqaron se në mbledhjen e rradhës do të miratohet rregullorja për kundravajtjet administrative, pjesë e saj është zënia se hapësirës publike dhe sapo të jetë funksionale do fillojë të japë rezultatet e duhura.

Z.Ervis Veizi, banor lagjia nr. 3 shprehet për një bllok pallatesh në rrugën Pjeter Gjini duhet të mendohet mundësia e rikualifikimit të tyre me kapotë. Po ashtu Shkolla Pashko Vasa ka nevojë për palestër ose terren sportiv të përshtatshëm edhe mot me shi. Gjithashtu duhet të ketë sallë kompjuterash për zhvillimin e mësimin për lëndën e TIK. Ngrohja e ambjenteve duhet të bëhet me kondicioner pasi ngrohja me dru është e rrezikshme sepse kemi shumë fëmijë më aftësi ndryshe. Edhe ndriçimi duhet të jetë me Led pasi ka rrezik për djegien e shkollës. Ai shton se shkolla ka nevojë po ashtu edhe për lysterje, gjelbërim dhe terrene sportive që mund të përdoren edhe nga komuniteti i zonës. Kemi probleme me bazën materiale në shkollën tonë si fotokopje e printera.

Z.Edmond Ndou, anëtar i KB dhe përfaqësues i rajonit nr. 3 shprehet se një pjesë e madhe e banorëve të kësaj zonë kanë qenë edhe përfaqësues në institucione publike e megjithatë zona ka shumë probleme të mungesës së investimeve. Ai shton se:

1. Zona muzeale është me shumë rrezikshmëri publike.
2. Trotualet e zëna në mënyrë abuzive krijojnë gjithmonë probleme.
3. Shtyllat dhe rrjeti elektrik apo interneti është jashtë kontrolli.
4. Infrastruktura në Skenderbeg dhe ish-Fermentim mungon dhe ka shumë nevoja.
5. Trafiku sidomos pranë shkollave është i rënduar.
6. Pallatet e vjetra tek ish dega ushtarake duhet parë mundësia për të rikualifikuar këto fasada me sistem kapot.
7. Fusha e lëkurave pjesë e rajonit. Nr. 3 që shfrytëzohet vetëm nga ekipi i Vllaznisë , mund të vendoset një orar ku fëmijët e zonës të mund të frekuentojnë këto mjedise sepse nuk ka asnjë mjedis publik për to.
8. Lagjia Tom Alimhilli dhe Tom Kola ka nevojë për sinjalistikë apo sistemim të qarkullimit
9. Peticione në vite për keto zona por nuk është marrë asnjë masë.
10. Sa i perket pastrimit me siguri me rregulloren e mbetjeve mund të ketë një sistemim të situatës sepse është edhe zonë industriale me shumë mbetje.
11. Problematikë mbetet edhe pjesa e tregut të Rusi, ku ka fluks të madh të banorëve dhe tregtarëve, duhet parë mundësia e krijimit të kushteve edhe për tregtarët e tjerë dhe të monitorohen mjediset publike duke mos lejuar tregtimin dhe ofruar hapësira tregtimi me kosto të ulët .
12. Sa i përket shkollave në këtë zonë, duke patur një infrastrukturë të dobët nxënësit rregjistrohen në shkolla të tjera duhet konsultuar me dr.arsimit.
13. Kërkohet shtim vemendjeje për transportin urban, frekuenca si dhe linjat e reja që ndihmojnë banorët.

Z. Florian Bjanku, banor i rajonit nr. 3 dhe anëtar i këshillit bashkiak shprehet se meqë diskutojmë për prioritetet mendoj që prioritare është jeta dhe siguria. Jane disa problematika që rrezikojnë jetën si p.sh: Godinat në zonën historike të qytetit rrezikojnë shembjen dhe mund të krijonin shumë pasoja. Janë prona private por ka edhe interes publik në rastet kur ka rrezik të banorëve e qytetarëve. Të gjindet forma për të komunikuar me keto subjekte dhe të identifikohen mënyrat për ndërhyrje. Ai shton se:

1. Qentë e rrugëve vijojnë të jenë shumë problematikë. Të merren masa pse jo edhe urgjente për të zgjidh këtë situatë sepse rrezikojnë edhe jetën e banorëve. Kemi patur raste të shumta kafshimesh.
2. Shkolla Branko Kadija, duhet riparë investimi në shkallët e hyrjes sepse jane shume të rrezikshme për përdoruesit e tyre.
3. Të mbahet parasysh infrastruktura e sigurisë, fikëse zjarri, rampa, dalje emergjente etj ndërhyrje që rrisin sigurinë e këtyre ambjenteve publike.
4. Mirëmbajtja e rrugëve dhe investimeve të realizuara. Duhet të ketë fonde mirëmbajtjeje për investimet e bëra sepse si për pedonalen apo rrugë të ndryshme nuk ka mirëmbajtje duke u detyruar pas pak vitesh të investohet nga e para.
5. Nuk ka një park lojrash të mirëmbajtur sepse të gjitha investimet që janë realizuar janë tashmë të prishura dhe do kishte mjaftuar mirëmbajtja e tyre.

Znj. Vjollca Petani, banore e lagjes nr. 3 G'juhadol dhe anëtare e Këshillit bashkiak shprehet se problem janë:

1. Tavolinat e lokaleve në pedonale .
2. Makinat e parkuara në zonë dhe në rrugicat pranë G'juhadolit krijojnë gjithmonë probleme mes banorëve dhe vizitorëve.
3. Akustika në zonë tashmë është e padurueshme. Jemi dakort me zhvillimin e jetës së natës dhe lokaleve por edhe ne banorët kemi të drejtat dhe nevojat tona per qetësi dhe rregull.

Zv/Kryetari përgjigjet se është diskutuar rreth kësaj problematike dhe do të realizojmë një balancim mes nevojave të banorëve dhe bizneseve. Kjo padyshim që ka të mirat e saj sepse vlera e pronave dhe të ardhurave në zonë është rritur sepse është një destinacion turistik tashmë por edhe banorët kanë të drejtat e tyre.

Z. Gjergj Sokoli, banor në zonën e lulishtes prapa Dollarit (Vaso Kadija) thotë se duhet të vendoset një tualet publik në këtë lulishte sepse ka shumë persona të moshës së tretë që duhet të kenë një shërbim të caktuar.

Znj. Rezarta Pode, anëtare këshilli Bashkiak thotë se:

1. Në rrugët kryesore të qytetit ka shumë pika qe pjekin gështenja, kuptohet që është punë për mbijetesë por krijon shumë problem për banorët. Duhet që Bashkia të ndërhyjë dhe të gjindet një sistemim.
2. Pemët dekorative në lagjen nr. 3 duhet të kene një vemendje të shtuar ndoshta nga shërbimi I gjelbërimit.

3. Po ashtu edhe rrjeti i kabllave dhe telave të internetit apo energjisë duhet të sistemohet pasi nuk është vetëm çështje estetike por edhe sigurie.

Znj.Uarda Gjekaj, anëtare e këshillit Bashkiak shprehet se edhe rruga At Shtjefen Gjecovi duhet përfshirë në rrjetin e rrugëve që po asfaltohen. Po ashtu ajo sugjeron që të vendoset edhe një semafor në bulevardin Nënë Tereza tek vojat e bardha pasi është segment që ka shumë lëvizje. Edhe rruga Palokë Kurti është rrugë që ka nevojë për ndërhyrje, riparime dhe mirëmbajtje pasi ka vështërsi kalimi aty edhe për ambulancat ose zjarrfikëset.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka kryetari i keshillit bashkiak falenderon të pranishmit dhe deklaroi të mbyllur takimin.


SEKRETAR

Denis LESHJA

Zbardhi process verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti












DEGJESE PUBLIKE PBA 2024-2026 BASHKIA SHKODER

LAGJJA/RAJONI : NR.3

LISTE PREZENCE

Aktiviteti: _____

Nr.	Emri Mbiemri	LAGJA/FSHATI	Kontakt	e-mail	Firma
	Toni Shtokaj	NR 3	0697049599	tonishashi@yahoo.com	
	Benin Mulla	NR 3	0642125390		
	Reulo Kocaj	NR 3	0696316604	reulo.kocaj@hedrica.com	
	Zef Kocaj	NR 3	0692615067	Zef.kocaj	
	Jozef Cose	NR. 3	0674428090	jozef.cose@gmail.com	
	Evan Gjini	NR. 3	0694083251	evangjini@gmail.com	
	Ardit Behri	K. B			
	Ilir Shala	K B	0684024687		
	Vilson Pelicaj	Nr. 3	0695757743	vildon.pelicaj	

Nr.	Emri Mbiemri	LAGJA/FSHATI	Kontakt	e-mail	Firma
	Paulin Stefej	Nr. 3	0697494400		
	Arbaug Dera	Nr. 3	0696090428	arbaughalilingua.com	
	Jorida Kuti	Nr. 3	0682340895		
	ALI NERGUTI	Nr. 3	0695143770	alinerkuti@gmail.com	
	Mariela Kopsatori	Nr. 3	0684508438	mariela.k@yahoo.com	
	Bujer Burazor	Nr. 3	0692274221		
	Moljo Bregje	Nr. 3	0692483873		
	Lulij Kolo	Nr. 3	0672040408		
	Hela Shironi	Nr. 3	0685487827		
	Agjill Lirvori	Nr. 3	0685690846		
	Enis Vez	Nr. 3	0695153331	enis-vez@tutimail.com	
	Cesk Ndou	Nr. 3	0695387777	Ceskndou8@gmail.com	
	EDMOND MDOU	Nr. 3	0684160626		
	Koli Hladaj	Nr. 3	0682424704	khladaj@gmail.com	
	Marbert Tomo	Nr. 3	0676868008	marbert.tomo@gmail.com	
	Edison Mirashi	Nr. Pjeter Budi	0682464915		
	Zeb Fall	Nr. Pjeter Bud	0689004111		
	Surila Mlloja	Nr. 3	0682632402	s.mlloja@yahoo.com	

Nr.	Emri Mbiemri	LAGJA/FSHATI	Kontakt	e-mail	Firma
	Suela Tirano	Nr. 3	0688517684	m.04.10p2r.c.@yahoo.com	
	Konstantin Elber	N. 1.	0682730219		

